



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 18.03.2019)*

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:38 dhe mbaroi në orën 15:57.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Brunilda Kadi* (anëtare)
4. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
5. *Illir Toska* (anëtar)
6. *Alban Toro* (anëtar)
7. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
8. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)

*Shënim:* Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti *Medi Bici* dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja *Fatmira Luli*.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
- 3. Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
- 4. Valbona Bako, Specialiste pranë institucionit.*
- 5. Përfaqësuese e Komitetit Kombëtar të Helsinkit.*

## **RENDI I DITËS:**

1. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.

*Naureda Llagami:* Atëherë, përshëndetje!

Po hapim mbledhjen plenare të datës 18.03.2019.

Të pranishëm janë të gjithë anëtarët, përveç zotit Medi Bici dhe zonjës Fatmira Luli.

Sikurse jeni vënë në dijeni, në rendin e ditës sot është një çështje e cila ka të bëjë me: Caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.

Bëj me dije se gjatë periudhës nga 14.02.2019 – 15.03.2019, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor janë depozituar rreth 68 kërkesa nga kryetarët respektiv të gjykatave, për delegimin e 100 gjyqtarëve në 68 çështje, me motivacionin se nuk kanë mundësi të shqyrtojnë një apo disa çështje brenda afateve të arsyeshme kohore. Shkaqet e pengesave janë paraqitja e heqjeve dorë, pranimi i kërkesave për përjashtim, vendimmarrjet e mëparshme apo konfliktet e interesit.

Për më shumë ia jap fjalën kryetarit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, zotit Toska, të raportojë projekt-aktin e propozuar.

*Ilir Toska:* Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur 21 relacione për të gjitha gjykatat në nevojë. Është propozuar në dy raste edhe refuzimi i kërkesave, sa i përket kërkesës së

bërë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Kjo duhet të jetë një çështje që duhet ta konsiderojë Këshilli në momentin që do trajtohen ato dy raste.

Ndërkohë keni edhe një relacion për radhën e procedurave të shortit sipas gjykatave që duhet ta miratojë paraprakisht Këshilli dhe më tej duhet të vijojmë procedurat e shortit.

Kemi propozuar të ndjekim si radhë shorti duke filluar nga gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm: Gjykata e Apelit Shkodër; pastaj apeli Durrës; pastaj apeli Vlorë; pastaj apeli Korçë; dhe në fund për Gjykatën e Apelit Gjirokastrë.

Pastaj është propozuar për gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, fillimisht ato nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Tiranë duke filluar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, më pas Kurbin, Mat dhe në fund Dibër.

Më tej gjykata e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Korçë që është vetëm Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Më tek është për gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Shkodër që është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe më pas Pukë.

Më pas është gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, fillimisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, më pas Sarandë dhe në fund Përmet.

Më tej propozimi vijon me gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Durrës, fillimisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe më pas Kavajë.

Dhe e fundit janë gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Vlorë që është vetëm Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

E fundit procedurë që kemi propozuar është ato për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit administrativ, fillimisht për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, më pas Gjirokastrë dhe në fund Shkodër.

Në të gjitha rastet kemi konsideruar që nuk zbatohet skema e delegimit se nuk ka gjyqtarë ende në skemë delegimi, po kështu nuk mund të aplikohet as transferimi i përkohshëm për shkak të numrit të kufizuar të çështjeve për të cilat janë në nevojë

gjykatat dhe e padobisë për të bërë transferim të përkohshëm për një numër të kufizuar çështjesh në gjykatat si më lart.

**Naureda Llagami:** Atëherë, ta kalojmë në votim për radhën e procedurës?

Pra hedhim në votim radhën e procedurës së propozuar nga kryetari i Komisionit, zoti Toska.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

**Ilir Toska:** Atëherë, duhet të vazhdojmë me procedurat e shortit për secilin.

Procedura e parë është për sa i përket nevojave të **Gjykatës së Apelit Shkodër**. Janë 7 çështje penale për të cilat ka paraqitur nevojë Gjykata e Apelit Shkodër (3 janë civile dhe 4 janë penale). Në 4 çështje kërkohet 1 gjyqtar, në 2 çështje 2 gjyqtarë dhe në 1 çështje 3 gjyqtarë. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e 7 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 7 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 6.

Njoftoj që të shpreheni lidhur me këtë propozim, nëse jeni dakord apo jo.

**Naureda Llagami:** E hedhim në votim?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

**Ilir Toska:** Mirë atëherë, vazhdojmë me procedurat e shortit.

Kemi propozuar që për 3 çështjet civile, për të cilat kërkohet caktimi i 1, 2 dhe 3 gjyqtareve, të caktohen 3 gjyqtarë, të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e seksionit civil të Gjykatës së Apelit Tiranë, ku për çështjen civile nr. 2, për të cilën kërkohen 3 gjyqtarë, gjyqtarët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e seksionit civile të

Gjykatës së Apelit Tiranë. Në këtë rast, përzgjedhja e gjyqtarit të parë, si relator, automatikisht përcakton edhe përzgjedhjen e dy gjyqtarëve të tjerë referuar përbërjes së trupit gjykues; Për çështjen civile nr. 1, për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, të caktohen 2 gjyqtarët e përzgjedhur si anëtarë për gjykimin e çështjes civile nr. 1; ndërsa për çështjen civile nr. 3, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short midis 2 gjyqtarëve të përzgjedhur si anëtarë për gjykimin e çështjes civile nr. 1. Në këtë rast kemi propozuar përjashtimin nga shorti, janë dy gjyqtarë që janë me leje nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me leje afatgjatë: {...} dhe {...}. Kemi propozuar të përjashtojmë nga shorti edhe gjyqtari anëtar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, zoti {...}, po kështu edhe kryetari në detyrë, zoti {...}. Kemi propozuar gjithashtu të përjashtohen nga shorti edhe gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, seksioni civil, që janë caktuar më herët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda dhe në Gjykatën e Apelit Korçë. Në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda janë për çështjet penale që do t'i vijojmë më pas procedurat. Sa i përket gjyqtarëve të seksionit civil që duhet të përjashtohen, kemi propozuar këta gjyqtarë: {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...} që janë caktuar në shortin e datës 19 në Gjykatën e Apelit Korçë. Jeni dakord të vijojmë?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Nxhirr seksionin civil të Gjykatës së Apelit Tiranë, përjashtuar gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}.

Atëherë, vazhdojmë procedurat për çështjen civile nr. 2 për të cilën kërkohet 3 gjyqtarë. Duhet të përzgjedhim 3 nga ata. Tërhiqet bileta e parë – është gjyqtari {...}. Automatikisht kemi konsideruar që do shkojë trupi gjykues që është me {...}n, që janë gjyqtarët {...} dhe {...}. Në këtë rast, për çështjen civile nr. 2 relator është gjyqtari {...} dhe dy anëtarët janë {...} dhe {...}.

Vijojmë procedurën e shortit për çështjen civile nr. 1 për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarë. Kemi propozuar të caktojmë dy anëtarët që u zgjodhën më herët, pra dy gjyqtarët që i bie të jenë gjyqtarët {...} dhe {...}, caktohen si anëtarë të trupit gjykues për çështjen civile nr. 1.

Për çështjen civile nr. 3 për të cilën kërkohen caktimi i 1 gjyqtari, të përzgjidhet me short midis dy gjyqtarëve të përzgjedhur si anëtarë, pra duhet të bëjmë një short mes dy gjyqtarëve {...} dhe {...}, për t'u caktuar si anëtar për çështjen civile nr.3. Atëherë, u përzgjedh gjyqtari {...}, për çështjen civile nr. 3 si anëtar.

Mbyllen procedurat e shortit për çështjet civile dhe vijojmë me procedurat e shortit për çështjet penale për Gjykatën e Apelit Shkodër.

Atëherë, për 4 çështjet penale për të cilat kërkohet caktimi i 1 dhe 3 gjyqtarëve, të caktohen 3 gjyqtarë të cilët përzgjidhen me short nga gjyqtarët e seksionit penal të Gjykatës së Apelit Tiranë. Në këtë mënyrë, për çështjen nr. 7 për të cilën kërkohen 3 gjyqtarë, gjyqtarët përzgjidhen me short nga gjyqtarët e seksionit penal të Gjykatës së Apelit Tiranë, për tre çështjet e tjera penale (ato 4, 5 dhe 6) për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, për secilën nga ato, gjyqtari përzgjidhet me short midis 3 gjyqtarëve të përzgjedhur për gjykimin e çështjes penale nr. 7. Në këtë rast, gjyqtari i përzgjedhur për çështjen e renditur e para në listë, përjashtohet nga përzgjedhja në çështjen e renditur më pas në listë. Jeni dakord me këtë propozim?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Vazhdojmë atëherë shortin për çështjen nr. 7 për të cilën kërkohen 3 gjyqtarë. Do të përjashtojmë në këtë rast nga shorti 3 gjyqtarët që janë caktuar më herët në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda, që janë {...}, {...} dhe {...}. Këta duhet të përjashtohen dhe të gjithë gjyqtarët e tjerë të seksionit penal të Gjykatës së Apelit Tiranë duhet të kenë emrat në enën përkatëse.

Vazhdojmë me procedurën e shortit, përzgjedhim nja nga shiritat. Gjyqtari i përzgjedhur me short është gjyqtari {...}. Në trupin gjykues që ndodhet gjyqtari {...} është edhe gjyqtari {...} dhe {...}. {...} kemi propozuar të përjashtohet nga shorti për shkak se prej disa javësh vijon të jetë në gjendje pamundësie shëndetësore dhe s'është paraqitur në detyrë. Kështu që automatikisht i bie që dy gjyqtarët që kemi përzgjedhur janë {...} dhe {...}. Do duhet të përzgjedhim një të tretë sepse të bëjmë një treshe të trupit gjykues. Do vazhdojmë përzgjedhjen për gjyqtarin e tretë – {...}. Atëherë, 3 gjyqtarët që caktohen për çështjen penale nr. 7 janë {...}, {...} dhe {...}. Gjyqtari {...} është edhe gjyqtari relator.

Vazhdojmë procedurat e shortit për tre çështjet e tjera penale (ato 4, 5 dhe 6) për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Shorti do të konsistojë në përzgjedhjen me short midis tre gjyqtarëve të përzgjedhur për çështjen penale nr. 7 ({...}, {...} dhe {...}). Për çështjen penale nr. 4 përzgjedhim një të biletë – {...}. Vazhdojmë për çështjen nr. 5 – {...}. Për çështjen nr. 6 – është zoti {...}. Me kaq mbarojnë procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Shkodër.

Vazhdojmë me procedurat e shortit për **Gjykatën e Apelit Durrës**.

Gjykata e Apelit Durrës ka 2 çështje civile për të cilat është në nevojë. Në një të kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ndërsa në çështjen tjetër kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e dy çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e dy çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë 2. Jeni dakord me këtë propozim?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Për çështjen civile nr. 2 për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e seksionit civil të Gjykatës së Apelit Tiranë. Në këtë rast kemi propozuar që të përjashtohen nga shorti, përveç dy gjyqtarëve që kanë leje afatgjatë {...} dhe {...}, gjyqtari anëtar i KED, zoti {...}, kryetari në detyrë, zoti {...}; po kështu kemi propozuar të përjashtojmë nga shorti gjyqtarët e seksionit civil që u përzgjedhën me short për Gjykatën e Apelit Shkodër (tre gjyqtarët që i caktuam më herët {...}, {...}, {...}). Hiqi këto bileta dhe fusni të gjithë gjyqtarët e tjerë.

Bileta e parë është gjyqtar {...} dhe bileta e dytë është {...}. Këta të dy caktohen për çështjen civile nr. 2, për të cilën kërkohet caktimi i dy gjyqtarëve.

Ndërsa për çështjen civile nr. 1 për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai duhet të përzgjidhet me short midis dy gjyqtarëve të përzgjedhur për çështjen nr. 2 ({...} dhe {...}). Tërheqim biletën – {...} caktohet si gjyqtar për çështjen nr. 1. Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Durrës.

Vijojmë me procedurën e shortit për **Gjykatën e Apelit Vlorë**.

Atëherë, Gjykata e Apelit Vlorë është në nevojë për 9 çështje, 5 çështje civile dhe 4 çështje penale. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët

që do caktohen për gjykimin e 9 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda dhe Gjykata e Apelit Gjirokastër. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 9 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë 5 (3 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit Gjirokastër dhe 2 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda). Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Mirë atëherë, vazhdojmë me procedurat e shortit për 4 çështjet penale, ato me numër 6, 7, 8 dhe 9, si dhe për çështjen civile nr. 3 për të cilën kemi propozuar që të caktohen 2 gjyqtarë të cilët të përzgjidhen me short nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda.

Për çështjen penale nr. 6 për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short midis gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda. Për çështjet e tjera penale, ato me nr. 7, 8 dhe 9 për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, të caktohen për t'u përzgjedhur me short midis 2 gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda të përzgjedhur për gjykimin e çështjes nr. 6. Ndërsa për çështjen civile nr. 3 për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, si i përzgjedhur me short konsiderohet gjyqtari që nuk është përzgjedhur për gjykimet e çështjes penale nr. 9. Në këtë rast, në rast se ky gjyqtar ka pengesë ligjore, si i përzgjedhur me short konsiderohet gjyqtari tjetër. Dhe po kështu, në rast se dy gjyqtarët e përzgjedhur nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda kanë pengesë ligjore për gjykimin e çështjes civile nr. 3, atëherë gjyqtari që do caktohet për këtë çështje, të përzgjidhet me short midis gjyqtarët e tjerë të kësaj gjykate. Çështja civile nr. 3 ka një veçanti për shkak se kemi bërë një short (shorti i datës 19) ku kemi caktuar 2 gjyqtarë të apelit të krimeve të rënda. Një nga gjyqtarët e apelit të krimeve të rënda që kemi caktuar më herët ka qenë gjyqtarja {...} e cila ka dhënë dorëheqjen. Në këto kushte jemi të detyruar të plotësojmë trupin gjykues me 1 gjyqtar, prandaj kemi propozuar që të jetë Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, gjykata ku më herët ne kemi propozuar që të plotësohet gjykata në nevojë, Gjykata e Apelit Vlorë.

Në këtë rast kemi propozuar që nga shorti të përjashtohet gjyqtari {...}, si gjyqtar anëtar i KED-së. Po kështu kemi propozuar të përjashtohet edhe kryetari i Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda {...}. Po kështu kemi propozuar që për çështjen civile nr. 3 të



përrjashtohen gjyqtarja {...}, e cila ka dhënë dorëheqjen nga kjo çështje, si dhe gjyqtare {...}, e cila është caktuar më herët nga ne për gjykimin e kësaj çështjeje me vendimin nr. 35, datë 19.02.2019.

Do vijojmë procedurat e shortit për çështjen penale nr. 6 për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve. Do fusim emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, duke përjashtuar kryetarin dhe zotin {...}.

Bileta e parë është emri i gjyqtares {...}.

Bileta e dytë është emri i gjyqtarit {...}.

Pra për çështjen penale nr. 6 janë 2 gjyqtarët {...} dhe {...}.

Vijojmë procedurat e shortit për çështjen penale nr. 7, 8 dhe 9 për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Ai caktohet duke u përzgjedhur me short midis 2 gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda të përzgjedhur për gjykimin e çështjes penale nr. 6 ({...} dhe {...}).

Vijojmë procedurën për çështjen nr. 7 - {...}.

Vijojmë procedurën për çështjen nr. 8 – që është gjyqtarja {...}.

Atëherë do të hedhim shortin edhe për çështjen nr. 9 midis këtyre 2 gjyqtarëve – {...}.

Për çështjen civile nr. 3 për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, kemi propozuar që të jetë gjyqtari që nuk është përzgjedhur për çështjen nr. 9, që i bie të jetë gjyqtari {...}. Pra për çështjen civile nr. 3, gjyqtari është {...}.

Vijojmë procedurat e shortit për 4 çështjen civile, 1, 2, 4, dhe 5, për të cilat kemi propozuar të caktohen tre gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

Në këtë rast kemi propozuar që të përjashtohet nga shorti vetëm kryetari i Gjykatës së Apelit Gjirokastër, zoti {...}.

Fut emrat e tjerë të Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

Atëherë, për çështjen civile nr. 2, 4, dhe 5 për të cilat kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastër, në këtë rast, gjyqtari i përzgjedhur i pari është automatikisht relator për çështjen nr. 2. Gjyqtari i përzgjedhur i dyti është automatikisht relator për çështjen nr. 4 dhe gjyqtari i përzgjedhur i treti është automatikisht relator për çështjen nr. 5.

Viojmë me shortin.

Atëherë, gjyqtari i përzgjedhur i pari është gjyqtarja {...} e cila është edhe relatores për çështjen civile nr. 2. Gjyqtari i përzgjedhur i dyti është {...}, i cili është edhe relator për çështjen civile nr. 4. Dhe gjyqtari i përzgjedhur i treti është gjyqtari {...}, i cili është edhe relator për çështjen civile nr. 5. Të tre këta janë edhe trupat gjykues për të tre këto çështje civile.

Viojmë procedurat e shortit për çështjen civile nr. 1 për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve. Ata të përzgjidhen me short mes 3 gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Gjirokastër të përzgjedhur për gjykimin e çështjes civile si më lart. Pra, mes gjyqtarëve {...}, {...} dhe {...}, do përzgjedhim 2 prej tyre.

I pari është {...}, dhe i dyti është {...}. Të dy këta gjyqtarë caktohen për gjykimin e çështjes civile nr. 1. Me kaq përfundojnë procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Vlorë.

Viojmë procedurat e shortit për **Gjykatën e Apelit Korçë**.

Nga Gjykata e Apelit Korçë, është në nevojë për 10 çështje (5 çështje penale dhe 5 çështje civile). Kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që duhet të caktohen për gjykimin e 10 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Apelit Shkodër. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet për gjykimin e 10 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë 6 (3 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe 3 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit Shkodër). Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord, vazhdojmë!

Atëherë, për 5 çështjet penale ato nr. 1, 2, 3, 4 dhe 10, kemi propozuar të caktojmë 3 gjyqtarë të cilët përzgjidhen me short nga Gjykata e Apelit Tiranë. Kemi propozuar të përjashtojmë nga shorti gjyqtarja që është në pamundësi shëndetësore prej disa javësh, {...} dhe gjyqtarët e seksionit penal të Gjykatës së Apelit Tiranë të cilët janë përzgjedhur me short për gjykimin e çështjes gjyqësore në Gjykatën e Apelit Shkodër, që janë gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}. Këta duhet të përjashtohen nga shorti, krahas gjyqtarës {...}. Gjyqtarët e tjerë duhet të përfshihen në short.

Për çështjen penale nr. 4 për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, në kushtet kur më herët, me vendimin nr. 35, datë 19.02.2019 Këshilli i Lartë Gjyqësor mbi kërkesën e paraqitur, ka caktuar një gjyqtar të Gjykatës së Apelit Tiranë, gjyqtaren {...}. Duke konsideruar procedurën e ndjekur në këtë rast, gjyqtari që kërkohet rishtazi të caktohet, kemi propozuar duke u përzgjedhur me short midis gjyqtarëve të tjerë që janë në përbërje të trupit gjykues ku është edhe gjyqtarja {...}, pra midis gjyqtarëve {...} dhe {...}.

Gjykata e Apelit Korçë, në kërkesën e bërë më herët kishte kërkuar vetëm 1 gjyqtar dhe ne kemi konsideruar që kërkohet 1 gjyqtar. Në fakt, me kërkesën e paraqitur, kërkon për të njëjtën çështje edhe një gjyqtar tjetër, pra ka dashur 2 gjyqtarë që në fillim. Duke konsideruar procedurën e mëhershme që kemi ndjekur më datë 19 shkurt, konsiderojmë që të bëhet një procedurë shorti, të zgjedhim një nga anëtarët e trupit gjykues, se e kemi përzgjedhur tashmë që herën e kaluar dhe do duhet të bëjmë një short midis gjyqtarëve {...} dhe {...}, për ta caktuar si gjyqtarë në çështjen penale nr. 4 - që është {...}.

Vazhdojmë për çështjen penale nr. 3 për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve që të përzgjidhen me short nga seksioni penal i Gjykatës së Apelit Tiranë – që janë {...} dhe {...}.

Për çështjet e tjera penale, ato me nr. 1, nr. 2 dhe nr. 10 për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, caktohet duke u përzgjedhur me short midis gjyqtarëve të seksionit penal të Gjykatës së Apelit Tiranë të cilët janë përzgjedhur për gjykimin e çështjes nr. 3. Në këtë rast, gjyqtari i përzgjedhur për çështjen e renditur të parë në listë, përjashtohet nga përzgjedhja e çështjes e renditur më pas.

Vazhdojmë shortin për çështjen nr. 1 – {...}.

Për çështjen nr. 2 – është zoti {...} dhe për çështjen nr. 10 do të hedhim short midis këtyre dy gjyqtarëve – që është {...}.

Vazhdojmë me procedurat e shortit për 5 çështjet civile, për çështjet nr. 5, 6, 7, 8, 9 për të cilat kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve, që kemi propozuar të përzgjidhen nga Gjykata e Apelit Shkodër. Për çështjen civile nr. 5, 6 dhe 8 për të cilat kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër, ku gjyqtari i përzgjedhur i pari përcakton edhe përzgjedhjen e dy gjyqtarëve të tjerë referuar

trupit gjykues në gjykatën nga e cila vijnë. Në këtë rast, përzgjedhja e gjyqtarit të parë përcakton si relator për çështjen e renditur e para në listë. Më pas shorti vijon për përcaktimin e gjyqtarit relator për dy çështjet e tjera të renditura më pas në listë, duke u përzgjedhur edhe ai me short midis dy gjyqtarëve të caktuar si anëtarë në çështjen e parë ku gjyqtari i përzgjedhur i pari në këtë rast është relator për çështjen e dytë, ndërsa gjyqtari tjetër është relator për çështjen e tretë. Emri i parë është {...} e cila caktohet edhe si relatore për çështjen civile nr. 5. Dy gjyqtarët e tjerë në përbërje të trupit gjykues që konsiderohen të përzgjedhur me short, krahas gjyqtarës {...}, janë {...} dhe {...}.

Do zhvillojmë një procedurë shorti për përcaktimin e relatorëve për çështjen nr. 6 dhe nr. 8 midis gjyqtarëve {...} dhe {...}.

Vijojmë procedurën e shortit për çështje nr. 6 – është gjyqtari {...}. Ndërsa për çështjen nr. 8 është gjyqtari {...}.

Vazhdojmë procedurat e shortit për çështjen civile nr. 7 për të cilën kërkohen caktimi i 2 gjyqtarëve. Ata të përzgjidhen me short midis 3 gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Shkodër të përzgjedhur për 3 çështje si më lart, pra midis gjyqtarëve {...}, {...} dhe {...}. Emri i parë i përzgjedhur është {...} dhe i dyti {...}. Për çështjen civile nr. 7, dy emrat e gjyqtarëve janë {...} dhe {...}.

Për çështjen e fundit civile, atë me nr. 9, gjyqtari që mbetet, gjyqtari {...}, caktohet gjyqtar i kësaj çështjeje civile për të cilën kërkohet caktimi i vetëm 1 gjyqtari. Me kaq përfundohen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Korçë.

Vijojmë me procedurat e shortit për **Gjykatën e Apelit Gjirokastrë** e cila është në nevojë për 3 çështje civile. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Korçë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e këtyre 3 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë 3. Jeni dakord me këtë?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Kemi propozuar që të përjashtohen nga shorti kryetarja në detyrë e Gjykatës së Apelit Korçë zonja {...}, ndërsa për çështjen e dytë të përjashtohet gjyqtarja {...} e cila ka pengesë ligjore, pasi e ka gjykuar më herët.

Mirë, vijojmë procedurat e shortit për çështjet penale, ato me nr. 1 dhe 2, për të cilat kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve që do përzgjidhen me short midis gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Korçë. Janë 3 gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Korçë që mbeten, po të përjashtohet nga shorti edhe kryetarja e gjykatës, që janë gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}. Do bëjmë shortin për të përcaktuar se kush është relator për çështjen 1 dhe çështjen 2. Për çështjen nr. 1 relator është gjyqtarja {...} dhe për çështjen 2 relator është {...}. Për çështjen civile nr. 3 për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari... Për çështjen nr. 2 përjashtohet nga shorti {...}.

Kemi çështjen nr. 3 për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari të përzgjedhur me short midis tre gjyqtarëve. Do të bëjmë një short midis tre gjyqtarëve – {...}. Pra për çështjen civile nr. 3 u përzgjedh gjyqtarja {...}.

Me kaq mbyllet shorti për Gjykatën e Apelit Korçë.

Atëherë, tek çështja nr. 2 janë 3 gjyqtarë në trup gjykues {...}, {...} dhe {...}. Për çështjen nr. 1 u përzgjedh gjyqtar relator {...}. Për çështjen 2 u përzgjedh relator {...} dhe i treti është {...}.

I bie që për çështjen nr. 2 të hyjë automatikisht Brunilda, se gjyqtare {...} përjashtohet nga shorti për shkak pengese. Pra për çështjen nr. 2 relator është {...}, anëtarë {...} dhe {...}.

Vijojmë me procedurat e shortit për gjykatat e shkallës së parë, fillimisht gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Tiranë. Fillimisht **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë**. Është në nevojë për 2 çështje penale. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe numri i gjyqtarëve për këto 2 çështje të jetë 3. Kemi propozuar që të përjashtohet nga shorti kryetarja e gjykatës {...}, si dhe gjyqtarët e seksionin penal që janë caktuar më herët për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin, konkretisht gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}. Do të fusim të gjithë emrat e gjyqtarëve të seksionit penal, që referuar informacionit të kryetares së gjykatës janë {...}, {...}, {...}, {...} që përjashtohet, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Vazhdojmë me procedurën për çështjen penale nr. 1 për të cilën kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve që do i zgjedhim mes gjyqtarëve të seksionit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Viojmë me shortin, emri i parë është – {...}, i cili është edhe relator i çështjes. Vazhdojmë me 2 emrat e tjerë – {...} dhe gjyqtari i tretë është {...}.

Për çështjen penale nr. 2 për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve të përzgjedhur nga shorti të konsiderohen 2 gjyqtarët e përzgjedhur si anëtarë për gjykimin e çështjes penale nr. 1, pra dy anëtarët e përzgjedhur në çështjen 1 janë {...} dhe {...}. Këta të caktohen si anëtarë për çështjen penale nr. 2. Me kaq mbyllet procedura e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin**.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin është në nevojë në 2 çështje penale dhe 2 çështje civile. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 3. Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Vazhdojmë atëherë, për çështjen penale nr. 2 për të cilën kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e seksionit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në këtë rast kemi propozuar që të përjashtohen nga shorti kryetarja e gjykatës {...}, gjyqtarët e caktuar më herët në shortin e një muaji më parë, gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}. Po kështu të përjashtohen nga shorti edhe gjyqtarët e caktuar në rrethin gjyqësor Krujë, {...}, {...} dhe {...}. Emrat e gjyqtarëve të tjerë duhet të përfshihen në procedurën e shortit.

Viojmë me procedurën e shortit për çështjen penale nr. 2 për të cilën do kryejmë caktimin e 3 gjyqtarëve. Emri i parë është {...}, e cila është edhe relatore e çështjes. {...} – është një nga anëtarët e trupit gjykues dhe {...}.

Për çështjen penale nr. 1 për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, të përzgjidhet me short mes 3 gjyqtarëve të seksionit penal të përzgjedhur për çështjen nr. 2, pra mes gjyqtarëve {...}, {...} dhe {...}. Emri i përzgjedhur me short është {...}, e cila caktohet në përbërje të trupit gjykues për çështjen penale nr. 1.

Vijojmë me dy çështjet e tjera gjyqësore, që janë çështjet civile nr. 2 dhe nr. 3 (*në fakt janë çështjet nr. 3 dhe 4*) për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Të caktohet një gjyqtar i cili të përzgjidhet përmes shortit nga gjyqtarët e seksionit civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në këtë rast do përjashtohen krahas kryetares së gjykatës edhe gjyqtarët e seksionit civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të cilët janë caktuar më herët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, konkretisht {...}, {...} dhe {...}. Për çështjen civile 2 dhe 3 (*çështjet civile 3 dhe 4*) do të përzgjedhim 2 gjyqtarë të seksionit civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, u përzgjedh {...}. Me kaq mbyllet procedura e shortit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Vazhdojmë procedurat e shortit për nevojat e **Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër**. Ka nevojë për një çështje penale për një gjyqtar. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhet me short gjyqtari që caktohet për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat dhe numri i gjyqtarit të jetë 1. Dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Vazhdojmë me procedurat e shortit. Do përfshihen të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat. Përzgjidhet 1 biletë. Është emri i gjyqtarit {...}, i cili caktohet si gjyqtar në çështjen në nevojë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër për çështjen penale me objekt: “Dhunë në familje”. Me kaq mbyllet procedura e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër.

Duhet të realizojmë procedurën e shortit për **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka nevojë për dy çështje, 1 çështje penale dhe 1 çështje civile. Në çështjen penale kërkohen 2 gjyqtarë dhe në çështjen civile kërkohet 1 gjyqtar. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen të jetë 2. Kemi propozuar që të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë zoti {...}. Atëherë, 2 gjyqtarët që mbeten në gjykatë... nëse jeni dakord me këtë propozim. Jeni dakord me propozimin që kemi bërë?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Atëherë, dy gjyqtarët që mbeten duke përjashtuar kryetarin në detyrë {...} janë {...} dhe {...}. Të dy këta gjyqtarë caktohen për çështjen penale nr. 1 në përbërje të trupit gjykues.

Vijomë procedurat e shortit për çështjen civile nr. 2 për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Do bëjmë një short midis këtyre 2 gjyqtarëve. {...} caktohet për çështjen civile nr. 2. Me kaq mbyllet procedura e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat.

Vijomë me gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Korçë, është një në fakt, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec**. Ka nevojë për 2 çështje gjyqësore (janë penale). Kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë 1 gjyqtar. Jeni dakord? Dakord.

Vazhdojmë procedurat e shortit. Kemi propozuar që të përzgjidhen nga gjyqtarët e seksionit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Do të bëjmë një short midis gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, ku do të përjashtohen dy gjyqtarët që janë caktuar më herët në shortin e bërë të datës 19 shkurt, janë gjyqtarët {...} dhe {...}, përfshirë edhe kryetaren e gjykatës {...}. Mbeten 2 emra në seksionin penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, që janë emrat e gjyqtarëve {...}... Në seksionin penal të Korçës ka tjetër?

Bëj të ditur se nga seksioni penal i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë ka 5 gjyqtarë. 3 gjyqtarë i përjashtuam për shkak të një, qenies në detyrë të kryetares {...} dhe dy gjyqtarë të caktuar më herët {...} dhe {...}. Ka mbetur vetëm një gjyqtar i këtij seksioni, gjyqtarja {...}. Do duhet të caktojmë dy gjyqtarë, kështu që i bie që të propozojmë që të zgjedhim nga seksioni civil i kësaj gjykate gjyqtarin e dytë për shkak se konsiderojmë të përjashtuar gjyqtarët e tjerë të seksionit penal.

Jeni dakord? Dakord.

Bëjmë një procedurë shorti midis gjyqtarëve të seksionit civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për caktimin e një gjyqtari...

Ju bëj të ditur se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka dy çështje për të cilat është në nevojë dhe kërkohet në të dyja rastet nga 1 gjyqtar. Kemi konsideruar që të jetë i njëjti gjyqtar në të dy çështjet, kështu që i bie që gjyqtarja {...} të jetë gjyqtare në të dy çështjet. Jeni dakord?

Atëherë mbyllet edhe procedura për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.



Vazhdojmë procedurat e shortit për **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë është në nevojë vetëm për një çështje penale. Kërkohej caktimi i 1 gjyqtari të vetëm. Kemi propozuar të jetë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër (nga seksioni penal i kësaj gjykate). Kemi propozuar të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë {...}.

Atëherë, fusim në enë emrat e gjyqtarëve të seksionit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Atëherë, u përzgjedh {...}. Pra gjyqtarja e seksionit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, caktohet në çështjen penale për të cilën është në nevojë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Me kaq mbyllet procedura e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë**. Është në nevojë për 2 çështje penale, ku kërkohej caktimi i 1 gjyqtari. Në të dy rastet kërkohej caktimi i 1 gjyqtari. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhet, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe numri i gjyqtarëve që duhet të përzgjidhet të jetë 1, që të jetë nga seksioni penal i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Kemi propozuar të përjashtohet kryetari në detyrë, {...}. Po kështu përjashtohet edhe gjyqtari i seksionit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër i cili ka pengesë ligjore për gjykimin e njëres prej çështjeve, për çështjen e parë, çështjen nr. 1. Atëherë, do të zhvillojmë short. Do të përjashtojmë edhe gjyqtarin që është përzgjedhur për në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, që ishte {...} dhe në seksionin penal mbetet që të caktohet vetëm gjyqtari Sokol Shehu, që i bie që s'ka nevojë për të vijuar procedurat e mëtejshme për shkak se përmes shortit dhe procedurave të tjera ndjekura më herët, janë përjashtuar gjyqtarët e tjerë. Pra për 2 çështjet për të cilat ka nevojë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë, caktohet gjyqtari Sokol Shehu. Me kaq mbyllet edhe procedurat e shortit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë.

Vazhdojmë me procedurat e shortit për **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë**. Atëherë, në këtë rast kemi dalë me dy propozime. Propozimi i parë është për refuzimin e kërkesës dhe nëse s'pranohet kjo duhet të vijojmë me procedurat e shortit. Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë referohet që është një çështje penale me objekt: "Verifikim i kallëzimit penal" të bërë kundër shtetasit {...} që është edhe

gjqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe është kërkuar sigurim prove marrja e dëshmisë së një shtetasi. Referohet që në këtë rast është thirrur si palë e tretë në proces gjyqtari {...}, gjyqtari ndaj të cilit është bërë kallëzimi penal. Referohet që gjyqtarit të cilit i është caktuar kërkesa rishtazi, pra gjyqtari {...} ka dhënë dorëheqjen dhe është miratuar dhe në këtë fazë të procesit, kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë i ka kërkuar Këshillit që të caktojë një gjyqtar nga një gjykatë tjetër të ndryshme nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për shkak se palë në proces në këtë çështje është një nga gjyqtarët e saj, gjyqtari {...}.

Në propozimin tonë të parë kemi propozuar që të refuzohet kjo kërkesë për shkak se referuar rregullores të miratuar nga ana jonë nuk identifikohet mungesa apo padisponueshmëri ligjore e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, pra nuk ka një akt formal dorëheqjeje nga të gjithë gjyqtarët, të miratuar edhe nga kryetari i gjykatës, që të konsiderojmë që jemi në kushtet e mungesës apo padisponueshmërisë ligjore të gjyqtarëve të asaj gjykate.

Kemi konsideruar që nuk mund të japim udhëzime apo të konsiderojmë vet nëse duhet apo jo të marrin pjesë në këtë çështje gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Kjo është një çështje që u përket autoriteteve gjyqësore, të cilat duhet ta marrin ato vendimin dhe në rast se kanë marrë një vendim të tillë, ne mund të konsiderojmë për ndjekjen e procedurave për caktimin e një gjyqtari nga një gjykatë tjetër.

Atëherë, duhet të votoni për propozimin e parë dhe nëse nuk kalon ky propozim, do të vijojmë me procedurat e shortit. Duhet të votohet nëse jeni dakord për refuzimin e kërkesës së kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë për caktimin e një gjyqtari për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë. Propozimi i parë është refuzimi i kërkesës. Nëse jeni dakord duhet të votoni.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë në votim propozimin e bërë nga kryetari i komisionit.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

*Alban Toro*: Dakord.

*Ilir Toska*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Erjon Muharremaj*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

*Ilir Toska*: Atëherë, meqenëse u miratua propozimi për refuzimin e kërkesës, nuk ka nevojë të vijojmë me procedurat e shortit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë duhet të njoftohet për këtë vendimmarrje, që të vijojë më tej procedurat gjyqësore lidhur me trajtimin e rastit që ndodhet para saj.

Vazhdojmë procedurat e shortit për **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë është në nevojë për 6 çështje (3 çështje civile dhe 3 çështje penale). Kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që caktohen për gjykimin e 6 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 6 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë 3 (ku 2 gjyqtarë të jenë nga seksioni civil i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe 1 gjyqtar të përzgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë). Jeni dakord.

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Vazhdojmë me procedurat e shortit për çështjen civile nr. 3 për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve që duhet të caktohen duke u përzgjedhur me short nga gjyqtarët e seksionit civil të i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Emri i parë është {...} dhe emri i dytë është {...}.

Për çështjet civile 1 dhe 2 për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ata të përzgjidhen me short midis dy gjyqtarëve të seksionit civil të përzgjedhur për çështjen nr. 3, midis gjyqtarëve {...} dhe {...}.

Vijojmë shortin për çështjen civile nr. 1. Përzgjidhet gjyqtari {...}.

Automatiksht për çështjen nr. 2 është gjyqtari {...}.

Për 3 çështjet penale nr. 4, 5 dhe 6 për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, të përzgjidhet me short midis gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, duke u

përrjashtuar në këtë rast kryetarja në detyrë {...} dhe gjyqtari {...}. Duke përrjashtuar dy gjyqtarët, të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër duhet të marrin pjesë në procedurën e shortit.

*(Përrzgjidhet {...}.)*

{...}.

Pra për 3 çështjet penale 4, 5 dhe 6 për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ky gjyqtar është {...}. Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Vijojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet është në nevojë për 1 çështje penale, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të caktohet gjyqtari, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier. Ky të jetë 1 gjyqtar i vetëm nga seksioni penal i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ku në këtë rast propozohet përrjashtimi vetëm për kryetarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, {...}. Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Vijojmë procedurat e shortit. Fusim në një enë emrat e gjyqtarëve të seksionit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, përrjashtuar kryetarin e kësaj gjykate. Atëherë, emri i përrzgjedhur është {...}, i cili caktohet për gjykimin e çështjes në nevojë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet. Me kaq mbyllet procedura e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet.

Vijojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan**. Edhe në rastin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan kemi dalë me dy propozime. Propozimi i parë është për refuzimin e kërkesës dhe e dyta, në rast se nuk miratohet ky propozim, duhet të vijojmë me procedurat e shortit.

Është referuar nga ana e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan se është një çështje civile, ku palë paditëse është një nga gjyqtarët e kësaj gjykate, zonja {...}. Referohet se kjo çështje civile fillimisht i është caktuar përrmes shortit gjyqtares {...}, e cila pas pretendimeve të paraqitura nga të paditurit, ka hequr dorë. Kërkesa është miratuar në atë rast nga kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe pas kësaj i është drejtuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duke i kërkuar caktimin e një gjyqtari për

këtë çështje civile. Këshilli i Lartë i Drejtësisë me vendimin e datës 11.10.2018 ka përjashtuar nga delegimi kërkesën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Pas këtij momenti, çështja është rishortuar përsëri, i ka rënë përsëri gjyqtarës {...}. Është pretenduar përsëri nga palët vijimi i ushtrimit të detyrës së gjyqtarit në këtë çështje të gjyqtarës {...}, po për të njëjtën arsye, për shkak se një nga palët në proces është gjyqtare e asaj gjykate. Ka riparuar përsëri dorëheqjen gjyqtarja {...}, duke konsideruar edhe një vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që ka konsideruar që pjesëmarrja e një gjyqtari në një gjykim ku është palë një nga gjyqtarët e asaj gjykate përbën shkak për njëanshmëri. Kjo kërkesë e fundit e gjyqtarës {...} nuk është shqyrtuar ende nga kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i cili kërkon që më parë të shprehet Këshilli i Lartë Gjyqësor, nëse do të mbajë qëndrim si ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë që ka konsideruar që të vijojë procesin nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan apo do përdor standard tjetër referuar qëndrimin të mbajtur nga KPK me vendimin nr. 95, datë 08.01.2019.

Kemi konsideruar se Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk mund të shprehet se si duhet të procedojë kryetari i gjykatës apo gjyqtarët që ngarkohen nga ligji për të konsideruar apo jo një kërkesë dorëheqjeje apo përjashtimin e një gjyqtari për një arsye specifike. Kemi konsideruar që ka ndalesë ligjore bile KLGJ, përveçse nuk është autoriteti gjyqësor që konsideron situata të tilla. Ato duhet t'i konsiderojnë vetë autoritetet gjyqësore, kryetari i gjykatës apo gjyqtari që mund të ngarkohet në një rast eventual për përjashtim gjyqtari dhe më tej, mund t'i drejtohen KLGJ-së në raste të mungesës apo të padisponueshmërisë ligjore të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Pra propozimi i parë është për refuzimin e kërkesës së kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Pra duhet të votoni këtë propozim tonin.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Alban Toro:** Dakord.

**Ilir Toska:** Dakord.

*Marçela Shehu*: Pro.

*Erjon Muharremaj*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

*Ilir Toska*: Në kushtet kur kërkesa e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan u refuzua, nuk ka vend për vijimin e mëtejshëm të procedurave të shortit. Duhet të njoftohet për vijimin e procedurave gjyqësore sipas ligjit Kodit të Procedurës Civile.

Viojmë me procedurat e shortit për **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë**. Ka nevojë për një çështje penale për 1 gjyqtar. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të caktohet të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1, aq sa ka nevojë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, i cili të përzgjidhet nga seksioni penal i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Kemi propozuar përjashtimin nga shorti në këtë rast të kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, {...}, si dhe të gjyqtarit që është caktuar më herët për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykata të tjera, zoti {...}. Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Mirë. Fusim në një enë emrat e gjyqtarëve të seksionit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, përjashtuar emrin e kryetares dhe të gjyqtarit {...}. Përzgjedhim një – {...} caktohet në përbërje të trupit gjykues, caktohet si gjyqtare në çështjen penale në nevojë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë. Me kaq mbyllet edhe procedura e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Viojmë me procedurën e shortit për **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje**.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje është në nevojë për një çështje penale, në të cilën kërkohet 1 gjyqtar dhe kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhet ky gjyqtar, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat. Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord. Viojmë me procedurat e shortit. Kemi propozuar të përjashtojmë nga shorti vetëm kryetarin në detyrë, {...}. Në një enë fusim emrat e të gjithë gjyqtarëve të tjerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat për të përzgjedhur njërin prej tyre. Emri i përzgjedhur është {...}, e cila caktohet për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit

Gjyqësor Lushnje, në çështjen penale që ajo ka paraqitur në nevojë. Me kaq mbyllet procedura e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje.

Viojmë me procedurën e shortit për **Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë**. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka nevojë për 1 çështje dhe caktimin e 1 gjyqtari. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhet ky gjyqtar, të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë. Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Kemi propozuar që të përjashtojmë nga shorti vetëm kryetarin e kësaj gjykate, zoti Astrit Shema. Atëherë, emrat e tjerë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, përzgjedhim njërin prej tyre – {...}. Pra për çështjen ne nevojë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë caktohet gjyqtari {...} i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Me kaq mbyllet procedura e shortit për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Viojmë me procedurën e shortit për **Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë**. Nga gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë është në nevojë për 4 çështje. Në secilin rast kërkohet caktimi i një gjyqtari. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë 1. Jeni dakord?

Kemi propozuar që të përjashtohet kryetari i gjykatës {...} si dhe gjyqtarët që janë caktuar më herët në shortin e datës 19 që janë gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}. Jeni dakord me këtë propozim?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord. Mirë atëherë, viojmë procedurat e shortit për përzgjedhjen e një gjyqtari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke përjashtuar gjyqtarët që përmenda më lart – Atëherë është {...}, e cila caktohet për të gjykuar 4 çështjet në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.

Me kaq mbyllet procedura e shortit për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.

Vazhdojmë procedurën e shortit për **Gjykatën Administrative të shkallës së Parë Shkodër**. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër është në nevojë për 7 çështje, ku kërkohet 1 ose 2 gjyqtarë. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e 7 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 2. Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord. Atëherë, vijojmë procedurat e shortit. Në këtë rast kemi konsideruar të përjashtojmë nga shorti kryetarin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, gjyqtarët që më herët janë caktuar për gjykimin e çështjeve në gjykatë tjetër në shortin e datës 19, pra gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}, po kështu edhe gjyqtari që u përzgjedh në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, {...}, të gjithë të tjerët do të marrin pjesë në procedurën e shortit.

Emri i parë është {...} dhe emri tjetër është {...}, të cilët caktohen të dy për çështjen nr. 3.

Për 6 çështjet e tjera ku kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, për çdo grup prej 3 çështjesh sipas renditjes së tyre në listë, gjyqtari të përzgjidhet me short midis dy gjyqtarëve të përzgjedhur si anëtarë për gjykimin e çështjes nr. 3. Pra do kemi çështjet 1, 2, 4 (një grup), pastaj 5, 6, 7 një grup tjetër, që duhet të jenë në një enë dhe emrat e dy gjyqtarëve në enën tjetër.

Atëherë, përzgjedhëm njërin nga grupet e çështjeve. Është grupi me çështjet 5, 6, 7. Do të përzgjedhim emrin e një gjyqtari. Është {...}. Pra për çështjet 5, 6, 7 gjyqtari është {...}. Për çështjet 1, 2, 4 gjyqtari është {...}. Me kaq mbyllet procedura e shortit për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe i gjithë shorti në tërësi. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Me kaq po e mbylлим edhe mbledhjen për ditën e sotshme.

Kemi gjë tjetër?

**Ilir Toska:** Po, desha të bëja prezent përpara Këshillit, që nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, na është kërkuar caktimi i gjyqtarëve për 247



çështje, 246 çështje. Duket që një sasi kaq e madhe çështjesh nuk mund ta trajtojmë nëpërmjet caktimit të gjyqtarëve për çështje të veçanta. Do duhet të konsiderojmë të bëjmë një transferim të përkohshëm. Nëse jeni okej parimisht, në mbledhjen e radhës, t'ju sjellim një propozim konkret ku të bëjmë shpalljen për transferim të përkohshëm (me pëlqim fillimisht) dhe të identifikojmë gjykatat që kanë ngarkesë më të ulët nga mund të jepet pëlqimi. Nëse jeni okej/dakord për këtë... Thjesht për të filluar ne disa procedura.

**Naureda Llagami:** Në fakt ajo është situatë e përsëritur që na është bërë me shkrim nga kryetarja.

**Ilir Toska:** Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër ka vetëm një gjyqtar të emëruar, ka edhe një gjyqtar të transferuar në mënyrë të përkohshme, që i mbaron transferimi në qershor. Ndërkohë janë dy vende vakante. Shumë shpejt do të jemi në situatën që do mbarojë edhe transferimi, ndërkohë kryetari i gjykatës është në procesin e rivlerësimit kalimtar. Do duhet të kemi një emërim të përkohshëm dhe do duhet të kemi një gjyqtar që duhet të fillojë të mbajë ngarkesën atje. Prandaj konsideruam t'ju bëjmë të ditur që ndërkohë të fillojmë të marrim masat për të bërë procedurat e transferimit të përkohshëm me pëlqim.

**Brikena Ukperaj:** Ne aktualisht nuk kemi një tabelë me ngarkesën aktuale të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, sa e kanë ngarkesën ata. Nëse do vendosim që të caktonim një gjyqtar vetëm për këto 249 a 246, mund ta bëjmë edhe nëpërmjet caktimit të përkohshëm duke lënë 3 muaj kohë që të shqyrtojë vetëm këto çështje. Në qoftë se do operojmë që pastaj ky gjyqtar që do shkojë do gjykojë përveç këtyre çështjeve, do hyjë edhe në short dhe do marrë çështje të tjera...

**Ilir Toska:** Sipas informacionit të kryetares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, të dy gjyqtarët, pra edhe ajo edhe gjyqtari tjetër që është me transferim të përkohshëm, kanë një ngarkesë të lartë çështjesh, deri diku tek 500 çështje. 246 çështje i përkasin gjyqtari që është pezulluar momentalisht nga detyra në kuadër të procesit të rivlerësimit, {...}, që s'janë shortuar, ndërkohë ata i kanë nga 500 çështje në dorë. S'ka ndonjë mundësi tjetër, përveçse të bëjmë ndonjë emërim, por emërimin e kemi për momentin... Mendoni që të vijojmë procedurat për të marrë informacionin nga gjykatat që kanë ngarkesë më të ulët.

Atëherë, ligji konsideron, për transferimin e përkohshëm me pëlqim, që të përzgjidhen nga gjykata që kanë ngarkesë më të ulët. Në vlerësimin tonë, konsiderojmë të identifikojmë 2-3 gjykata që kanë ngarkesë më të ulët, t'ua bëjmë prezent dhe mbasi do jeni dakord edhe ju, të bëjmë shpalljen për këtë pozicion vakant të përkohshëm dhe t'i bëjmë thirrje atyre gjyqtarëve të këtyre gjykatave, nëse japin apo jo pëlqimin. Në të kundërt, do vijojmë me procedurat e transferimit të detyrueshëm.

**Brikena Ukperaj:** Problemi është që nga cilat gjykata do ta fillojmë procedurën.

**Naureda Llagami:** Ta sqarojmë radhën tjetër.

**Ilir Toska:** Ajo që po kërkojmë ne, nëse e konsideroni se duhet që këtë situatën që kemi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, ta zgjidhim me transferim të përkohshëm, -okej, ne duhet të marrim informacion për gjykatat që kanë ngarkesë më të ulët dhe t'ua bëjmë të ditur mbledhjen e radhës.

*(Zonja Ukperaj merr fjalën pa ndezur mikrofonin.)*

**Brikena Ukperaj:** Ideja ime është që është nga gjykatat administrative apo nga gjykatat civile? Se për delegimet po ndjekim logjikën që çështjen ta gjykojë gjyqtari sipas lëndës...

*(Zonja Ukperaj ndez mikrofonin.)*

Atëherë, ideja është që nga cilat gjykata do të shikojmë ngarkesën më të ulët, nga gjykatat civile të juridiksionit të përgjithshëm apo nga gjykatat administrative?! Se për delegimet po ndjekim logjikën që duhet të gjykohet çështja nga gjyqtari sipas lëndës dhe po i delegojmë për gjykatat administrative. Ndërkohë që, si do të operojmë për transferimin?

**Brunilda Kadi:** Unë vlerësoj që s'mund ta marrim në këtë moment këtë vendim sepse duhet të kemi dy informacione bazë që të arsyetojmë. Unë vlerësoj që në mbledhjen e radhës, ta diskutojmë në parim sepse s'mund ta vendosim tani pa rend dite. Të shikojmë edhe një lloj raporti edhe një lloj relacioni, cilat do jenë pjesët për diskutim. Kjo që tha Brikena për shembull tani, mund të ketë edhe çështje të tjera. Kështu që unë mendoj që s'mund ta vendosim në këtë moment.

**Ilir Toska:** Ajo që shtruar për diskutim është që a mendoni që ka një mekanizëm tjetër përveç transferimit të përkohshëm? Pastaj, nëse do konsiderojmë që është një

gjykatë, dy gjykata apo tre gjykata, është një çështje që do e marrim vendim këtu në mbledhje. Ne mund të marrim informacion dhe t'ua bëjmë prezent këtu. Ajo që po kërkojmë është, -a të fillojmë të marrim informacion, për të konsideruar që i vetmi mekanizëm për momentin është transferimi i përkohshëm. Kaq ishte çështja.

*Naureda Llagami:* Atëherë, lidhur me çështjen, sugjeroj që ne do fillojmë njëherë të përgatiten/të fillojnë procedurat. Të lexojmë korrespondencat nëpërmjet gjykatave, si është numri, dhe më pas e fusim çështje në rendin e ditës në mbledhjen më të afërt. Dakord?

Faleminderit!

Mirupafshim!

\* \* \*

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**